



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

LIGJ

Nr. 76/2018

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË MALIT
TË ZI PËR HAPJEN E PIKËS SË PËRBASHKËT TË KALIMIT KUFITAR ZOGAJ
(REPUBLIKA E SHQIPËRISË) – SKJE (MALI I ZI), PËR QARKULLIMIN
NDËRKOMBËTAR RRUGOR DHE TË PASAGJERËVE NË LIQENIN
E SHKODRËS**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Malit të Zi për hapjen e pikës së përbashkët të kalimit kufitar Zogaj (Republika e Shqipërisë) – Skje (Mali i Zi), për qarkullimin ndërkombëtar rrugor dhe të pasagjerëve në liqenin e Shkodrës, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

K R Y E T A R I

Gramoz RUÇI

Miratuar në datën 1.11.2018